

VENDIM
Nr.459, datë 16.4.2008

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE DHE PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES
PËR DHËNIEN ME KONCESION TË SHOQËRISË “KRIPA” SHA VLORË DHE MIRATIMIN E
BONUSIT NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4 pika 2, 5 pikat 1 e 3, e 23 pika 3 shkronja “b” të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrisë të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për dhënie me koncesion të shoqërisë “Kripa” sh.a. Vlorë.
2. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënie me koncesion të shoqërisë “Kripa” sh.a. Vlorë, është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.
3. Miratimin e bonusit prej 8 për qind të pikëve për studimin ekonomiko-financiar, studimin e fizibilitetit e të zgjidhjes teknike për ngritjen e linjave të prodhimit dhe për raportin për ndikimin mjedisor, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar), që i jepet shoqërisë “Alb-Sale” sh.a. Vlorë.
4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha